



RREGULLORE PËR TEMËN E DIPLOMËS

NË PROGRAMIN E STUDIMIT FARMACI

Tema e diplomës është një punim i shkruar nga studenti dhe mund të jetë, sipas zgjedhjes, shtjelluese ose eksperimentale dhe përgatitet nën drejtimin e një Udhëheqësi dhe një Bashkë-Udhëheqësi.

Udhëheqësi duhet të jetë një pedagog zyrtar i programit të studimit në Farmaci, ndërsa bashkë-Udhëheqësi mund të mos jetë profesor i Fakultetit, për sa kohë që ai është një personalitet i njohur shkencor ose profesional.

Tema shtjelluese konsiston në mbledhjen dhe përpunimin e materialeve bibliografike ose të të dhënave të tjera për një temë të zgjedhur nga studenti në marrëveshje me Udhëheqësin, përmbajtjet kulturore dhe profesionale të së cilës janë në përputhje me ato të programit të studimit. Ka një kohëzgjatje jo më pak se **3** muaj për një total prej 15 ECTS. Studentët të cilët zgjedhin të bëjnë një temë kurrikulare, duhet të marrin të paktën edhe 8 ECTS nga “*Njohuri të tjera për hyrjen në tregun e punës*” për të arritur 300 ECTS të programit të studimit.

Tema eksperimentale përbëhet nga një hulumtim eksperimental dhe origjinal i kryer me kontributin e Studentit në laboratorët e Universitetit “Zoja e Këshillit të Mirë” (UKZKM) ose të Universitetit të Milanos (UniMI), ose të organeve të tjera publike ose private, shqiptare ose italiane, për një kohëzgjatje jo më pak se 6 muaj për gjithsej 23 ECTS. Temat eksperimentale në Itali do të zhvillohen në mënyrë preferenciale pranë një laboratorit kërkimi të Departamentit të Farmacisë-Shkencave të Barnave në UNiBA.

Komisioni i diplomimeve emërohet nga Rektori dhe përbëhet nga Dekani i Fakultetit të Farmacisë të UKZKM, ose zëvendësi i tij, dhe nga jo më pak se shtatë pedagogë të Fakultetit, nga të cilët të paktën tre titullarë të lëndëve të Fakultetit.

Nota e diplomimit, shprehur në njëqind e dhjetë, rrjedh nga mbledhja e parametrave të mëposhtëm:

- a) mesatarja aritmetike e ponderuar e krediteve të notave të marra në provimet kurrikulare, të shprehura në njëqind e dhjetë (mesatarja e ponderuar llogaritet si më poshtë:



Mesatarja vlerësuar me 30:	shuma e notave shumëzuar me kreditet përkatëse

	shuma e krediteve të parashikuara për provimet që llogariten në mesatare
Mesatarja vlerësuar me 110:	rezultati i mesatares së ponderuar 30x110

	30

- b) Pikët e dhëna nga Komisioni i diplomës gjatë diskutimit të temës, me propozim të Udhëheqësit, pas mbrojtjes së temës, përfshihen ndërmjet një minimumi dhe maksimumi në funksion të mesatares/110, duke e rumbullakosur në rast mangësish me vlerën më të afërt, sipas tabelës së bashkëlidhur, ku pikët shtesë për qëndrimin jashtë shtetit duhet të kuptohen si veprimtari Erasmus.
- c) Notës së llogaritur si në pikën b, i shtohen pikët shtesë të bonusit 4 ose 2 pikë, në bazë të faktit nëse diploma do të merret respektivisht brenda sezonit të jashtëzakonshëm të prillit të vitit të 5-të dhe të 6-të.
- d) Mund të propozohet nga Udhëheqësi edhe shkëlqyeshëm për kandidatët që arrijnë rezultatin e përgjithshëm (mesatarja e provimeve + pikët për temën + pikët shtesë) ≥ 113 , dhe i jepet unanimisht nga gjithë Komisioni i diplomimit.
- e) Nota përfundimtare 99 dhe 10 respektivisht nuk mund të rumbullakoset me 100 deri në 110.

Seancat e diplomimit si rregull mbahen në periudhat prill, korrik, dhe nëntor (kur sezoni i muajit prill është sezon i jashtëzakonshëm i vitit akademik të mbyllur në tetorin e kaluar), duke përjashtuar këtu kërkesa të veçanta.

Formati i temës së diplomës: tema e diplomës duhet të paraqitet e shkruar në italisht, në dy kopje të shtypura dhe një kopje në CD.

Të gjitha kopjet duhet t'i dorëzohen Sekretarisë Mësimore të UKZKM pesëmbëdhjetë ditë para datës së caktuar për diskutim.

Detyrime formale që duhet të përmbushen nga studentët që do të diplomohen

Për t'u pranuar në provimin e diplomimit, studenti i diplomuar duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme në Sekretarinë Mësimore të UKZKM.

Për t'u pranuar në provimin e diplomës studenti që po diplomohet duhet të paraqesë në Sekretarinë Mësimore dokumentet e mëposhtme:



- a. Aplikimin për caktimin e temës (FORMULARI 1) i nënshkruar nga Udhëheqësi dhe, ndoshta, edhe nga Bashkë-Udhëheqësi. Kërkesa duhet t'i drejtohet Dekanit të Fakultetit dhe të depozitohet në Sekretarinë Mësimore: të paktën 6 muaj më parë në rastin e një teme eksperimentale, të paktën tre muaj para seancës së provimit të diplomimit në rastin e një teme shtjelluese.
- b. Në mënyrë që të paraqesë aplikim për caktimin e një teme diplome, studenti duhet të ketë dhënë provime kurrikulare duke marrë jo më pak se **200 ECTS** dhe të jetë në rregull me pagesën e tarifave të kërkuara. Në mënyrë që të paraqesë kërkesën për caktimin e një teme të një diplome eksperimentale, studenti duhet të ketë dhënë provime kurrikulare dhe të ketë marrë jo më pak se **180 ECTS** dhe duhet të jetë në rregull me pagesën e tarifave të kërkuara.
- c. 2 muaj para seancës së diplomimit paraqitet kërkesa për pranimin në provimin e diplomës (FORMULARI 2), nënshkruar qoftë nga Udhëheqësi qoftë nga Bashkë-Udhëheqësi. Formulari 2 duhet t'i drejtohet Rektorit të UKZKM.
- d. Një muaj përpara sezonit të provimit paraqitet Deklarata e Miratimit (FORMULARI 3).
- e. Një muaj përpara seancës së diplomimit studenti duhet të paraqesë:
 1. Librezën universitare.
 2. Librezën dhe formularët për praktikën e zhvilluar.
 3. Fatura e pagesës së tarifës së diplomës universitare të UKZKM.
 4. Deklarata për bibliotekën.
 5. Deklarata e financës që studenti është në rregull me shlyerjen e detyrimeve.
- f. 15 ditë përpara seancës së diplomimit studenti duhet të paraqesë temën e shkruar në gjuhën italiane në dy kopje të shtypura dhe një kopje CD.

DETYRIME FORMALE NGA SEKRETARIA E STUDENTËVE TË UKZKM DHE KOMISIONI I PËRBASHKËT DIDAKTIK

SEKRETARIA MËSIMORE E STUDENTËVE TË UKZKM, duhet të përcjellë në UniBA, një kopje të kurrikulës së diplomës, të certifikatave në lidhje me praktikën e kryer prej tyre në Farmaci, të aplikimit për temën e diplomës, procesverbalit të seancës së diplomimit dhe çdo dokumenti tjetër që lidhet me karrierën e studentëve. Dokumentacioni i sipërpërmendur duhet të vërtetohet nga **KOMISIONI I PËRBASHKËT DIDAKTIK**, para mbrojtjes së temës së diplomës.

Caktimi i temës

Kërkesat për caktimin e temës, të paraqitura në Sekretarinë Mësimore të UKZKM, shqyrtohen nga dy të ngarkuar, të emëruar nga **KOMISIONI I PËRBASHKËT DIDAKTIK**, të cilët, pasi këshillohen me Dekanin dhe Udhëheqësit (dhe ndoshta edhe bashkë-Udhëheqësit), verifikojnë përputhshmërinë e kurrikulës formuese të studentit dhe përshtatshmërinë e mjediseve në të cilat do të zhvillohet tema.

KOMISIONI I PËRBASHKËT DIDAKTIK i komunikon Dekanit të Fakultetit listën e temave të caktuara duke caktuar emrin e Udhëheqësit, mundësisht edhe të Bashkë-Udhëheqësit atë të studentit, temën e zgjedhur, datën e caktimit dhe strukturën në të cilën do të përgatitet tema. Dekani i Fakultetit ratifikon me firmën e tij caktimin e tezës së diplomës.



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

FAKULTETI I FARMACISË

Sekretaria Mësimore ia përcjell studentit letrën e caktimit të temës së diplomës.

Një kopje e nënshkruar nga studenti për marrjen e njoftimit mbetet në regjistrat e Sekretarisë që kujdeset për dosjen e temave të caktuara.

Aplikimi për Diplomimin

Sekretaria Mësimore e UKZKM dërgon dokumentet e kërkuara të marra nga studentët në **KOMISIONIN E PËRBASHKËT DIDAKTIK.**

KOMISIONI I PËRBASHKËT DIDAKTIK mblidhet, qoftë edhe në mënyrë elektronike, dhe shqyrton dokumentet e marra nga Sekretaria Mësimore e UKZKM, duke përfshirë aplikimet për pranimin në temë, procesverbalet e provimeve të mbartura nga studentët e diplomuar dhe të gjitha dokumentet e kërkuara për dorëzimin në zyrat e UNIBA. Pasi të vërtetohen, dokumentet dërgohen në Sekretarinë e Studentëve të UNIBA.

Koordinatori i programit të studimit thërret anëtarët e Komisionit, përfshirë Udhëheqësit dhe Bashkë-Udhëheqësit, gjithashtu duke u dërguar atyre listën e studentëve të diplomuar, jo më vonë se 15 ditë para çdo seance diplomimi.

Data 23/04/2019

ADMINISTRATORI

(Nënshkrimi)

DEKANI

(Nënshkrimi)

REKTORI

(Nënshkrimi, vula)



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

FAKULTETI I FARMACISË

FORMULAR 1

UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË – TIRANË
FAKULTETI I FARMACISË
PROGRAMI I INTEGRUAR I STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NË FARMACI

DEKANIT TË FAKULTETIT

I/E nënshkruara _____

Me nr. matrikulle _____ lindur në _____

Banues në _____ në rrugën _____

Regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në Farmaci për vitin akademik _____.

Kërkon të mund të përgatisë temën e diplomës:

a. Kurrikulare (tema) _____

b. Eksperimentale (tema) _____

Pranë Institutit/Labororit _____

Nën drejtimin e Udhëheqësit: Prof: _____

Dhe të Bashkë-Udhëheqësit: Prof _____

Tiranë, më _____

Firma e studentit _____

Firma e Udhëheqësit _____

Firma e Bashkë-Udhëheqësit Prof. _____



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

FAKULTETI I FARMACISË

REKTORIT TË NDERUAR
TË UNIVERSITETIT KATOLIK “ZKM”
TIRANË

I/E Nënshkruara _____

Me nr. matrikulle _____ lindur në _____

banues në _____ në rrugën _____

Tel. _____, regjistruar në programin e studimit në FARMACI për vitin akademik _____

Pasi ka punuar nën udhëheqjen e Udhëheqësit Prof. _____

Dhe Bashkë-Udhëheqësit Prof.: _____

Temën e diplomës (eksperimentale/kurrikulare) me titull: _____

KËRKON

- a) Të pranohet për të mbrojtur provimin e diplomës në sezonin ____
- b) Të vitit akademik _____
- c) Lëshimin e diplomës origjinale të universitetit, sapo të jetë gati;
- d) Ti kthehet diploma origjinale e maturës depozituar pranë zyrave tuaja.

Tiranë më _____ FIRMA _____

Miratuar

Relator: Prof. _____ Bashkë -Relator: Prof. _____

Bashkëlidhur libreza e universitetit.



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

FAKULTETI I FARMACISË

DEKLARATA E MIRATIMIT

FAKULTETI I _____

PROGRAMI I STUDIMIT _____

Deklarohet se studenti _____ ka zhvilluar nën udhëheqjen time temën e diplomës në _____ me titull:

“: _____”

Relator

Prof./Pedagoge _____

Bashkë - Relator

Prof./Pedagoge _____



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

FAKULTETI I FARMACISË

(Logo)

UNIVERSITETI KATOLIK
“ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË”

(Logo)

UNIVERSITETI I STUDIMEVE TË BARIT
“ALDO MORO”

FAKULTETI I FARMACISË
PROGRAMI I INTEGRUAR I STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NË FARMACI

TEMA E DIPLOMËS

(TITULLI I TEMËS)

XX
XX
XXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXX

RELATOR:
Prof. Emër MBIEMËR

STUDENTI
Emër MBIEMËR
Matrikulla

BASHKË-RELATOR
Prof. Dr. Emër MBIEMËR

VITI AKADEMIK
20.....20..

Deklarohet se ky përkthim është i njëjtë me tekstin origjinal në gjuhën italiane dhe se është kryer nga “Xhuljeta Kasmollari”, përkthyes e njohur dhe akredituar pranë Ministrisë së Drejtësisë shqiptare.